

VENDIM
Nr.213, datë 7.4.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI PËR INSTALIMIN E
DRITAVE TË ULJES NË AEROPORTIN “NËNË TEREZA” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti për instalimin e dritave të uljes në aeroportin “Nënë Tereza” sh.a.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të aeroportit “Nënë Tereza” sh.a.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 14 791 m² tokë arë, me çmimin 1164 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë/m² me vlerë të përgjithshme 17 216 724 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 17 326 724 (shtatëmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh të përballohet nga fondet e aeroportit “Nënë Tereza” sh.a.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.4.2005.
 7. Punimet të fillojnë më datë 1.5.2005 dhe të mbarojnë më datë 30.6.2005.
 8. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët në kolonën “Shënime” është shkruar “Plotësim dokumentacioni”, të marrin shpërblimin për efekt të shpronësimit, pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.
 9. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe aeroporti “Nënë Tereza” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA JURIDIKE
 QARKU DURRES

**Lista e pronareve qe preken nga projekti i realizuar per instalimin e Dritave te Uljes
 se Aeroportit " Nene Tereza "**

Lloji i pasurise se paluajtshme: toke are

Nr	Emer	Atesia	Mbiemri	Nr. pas.	Toke are			Shenime
					Sip. m ²	Cmimi l/m ²	Vlera leke	
1	Asllan	Hamdi	Kodra	161/5	856	1164	996384	konfirmim nga Z.Rr.P.P
2	Fatbardh	Ymer	Ahmeti	161/4	536	1164	623904	konfirmim nga Z.Rr.P.P
3	Basri	Islam	Mana	121/2	10757	1164	12521148	plotesim dokumentacioni
4	Basri	Islam	Mana	118/1	1334	1164	1552776	plotesim dokumentacioni
5	ANTA			160	1308	1164	1522512	konfirmim nga Z.Rr.P.P
	Shuma				14791		17216724	

Shpenzime procedurale leke 110 000
Vlera totale e shpronesimit leke 17 326 724